



Dahlia



Estetiste për trajtimin e trupit dhe fytyrës

Përshkrimi i pozicionit të punës:

Dahlia është në kërkim të një estetisteje me eksperiencë, që të ketë njohuri të thella rreth trajtimeve dhe pajisjeve për fytyrën dhe trupin dhe të dijë të punojë mirë në grup. Estetistja, nëpërmjet njohurive të saj për biologjinë e lëkurës, anatominë dhe kiminë kozmetike, ofron një sërë trajtimesh për fytyrën dhe trupin për meshkuj dhe femra, të përshtatura sipas nevojës së klientit si edhe rekomandon produktet e duhura për kujdesin e mëvonshëm.

Detyrat kryesore:

- Të bëjë check-up e lëkurës me pajisjen përkatëse dhe të këshillojë klientet për kujdesin ndaj lëkurës
- Të kryej trajtime të ndryshme të fytyrës sipas dëshirës dhe nevojës së klientit duke përdorur kur është e nevojshme edhe pajisjet e duhura
- Të kryej trajtime të ndryshme të trupit duke përdorur pajisjet e përshtatshme
- Të kryej masazhe të ndryshme të fytyrës dhe trupit (relaksuese, aromatherapy, me gura vullkanike, etj.)
- Të dijë të përdorë llampën pulsante për depilimin permanent, heqjen e njollave, etj.
- Të shesë dhe këshillojë klientët për produktet kozmetike

Cilësitë personale:

- Mos të ketë alergji nga produktet kozmetike
- Të ketë paraqitje të rregullt dhe të kuruar
- Të jetë diskrete në lidhje me trajtimet që i ofron klientëve
- Të ketë aftësi të mira komunikuese

Kualifikimet profesionale:

- Të ketë përfunduar me sukses shkollimin e duhur për estetikë

- Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë
- Gjuhët e huaja janë një aset që do të merret në konsideratë

Estetiste për trajtimin e thonjve

Përshkrimi i pozicionit të punës:

Dahlia është në kërkim të një estetisteje për trajtimin e thonjve me eksperiencë, kreative, të apasionuar pas profesionit të saj, të informuar dhe të interesuar për trendet e momentit dhe me aftësi shumë të mira komunikimi. Estetistja duhet të bëjë trajtime të duarve dhe këmbëve, manicure, pedicure, vendosjen dhe mbushjen e thonjve, kurimin e thonjve të dëmtuar dhe stilime të thonjve. Gjithashtu estetistja duhet të ketë njohuri dhe eksperiencë në depilimin me dyll.

Detyrat kryesore:

- Të vendosë dhe mbushë thonjë me xhel dhe akrilik duke përdorur mjetet dhe pajisjet përkatëse
- Të bëjë manicure dhe pedicure
- Të stilojë thonjtë me dorë të lirë gjithashtu duke përdorur teknika dhe mjete të ndryshme
- Të dijë të trajtojë thonjtë dhe lëkurën e dëmtuar të duarve dhe këmbëve
- Të këshillojë klientët për mirëmbajtjen e thonjve dhe lëkurës së duarve dhe këmbëve
- Të bëjë depilim me dyll të të gjithë pjesëve të trupit

Cilësitë personale:

- Mos të ketë alergji nga produktet kozmetike që përdoren
- Të ketë sjellje të qetë e të duruar
- Të ketë paraqitje të rregullt dhe të kuruar
- Të jetë diskrete në lidhje me trajtimet dhe shërbimet që i ofron klientëve
- Të ketë aftësi shume të mira komunikuese
- Të ketë aftësi krijuese dhe artistike

Kualifikimet profesionale:

- Të ketë përfunduar me sukses shkollimin e duhur për estetikë për trajtimin e thonjve
- Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë
- Gjuhët e huaja janë një aset që do të merret në konsideratë

Parukiere

Përshkrimi i pozicionit të punës:

Dahlia është në kërkim të një parukieri/eje me eksperiencë, që të dijë të punojë mirë në grup dhe të jetë i/e apasionuar dhe i/e azhurnuar me trendet dhe produktet e momentit. Parukieri/ja pret, stilon, lye, dekolon, kreh, bën permanent dhe trajtime të ndryshme të flokëve për ferma dhe meshkuj.

Detyrat kryesore:

- Konsultohet me klientin për shërbimin e kërkuar duke ofruar edhe sygjerimet e veta profesionale
- Pret flokët duke përdorur gersheret ose makinën e rrojes
- Lan me shampo, aplikon balsamin dhe shplan flokët
- Oforn shërbime si lyerja, dekolrimi, aplikimi i trajtimeve të flokëve dhe permanent
- Than flokët duke përdorur furcat, krëhërat, mashat për drejtim ose për bërjen e kaçurelave
- Stilon flokët
- Vendos dhe heq flokët artificiale (extensions)
- Këshillon klientët për kujdesin ndaj flokëve

Cilësitë personale:

- Mos të ketë alergji nga produktet e flokëve
- Të ketë personalitet të këndshëm
- Të ketë aftësi të mira komunikuese
- Të jetë kreative dhe e vëmendëshme ndaj detajeve

Kualifikimet profesionale:

- Të ketë përfunduar me sukses kursin për parukier/e
- Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë
- Të njohë produktet e L'Oreal Paris, Majirel dhe Inoa
- Gjuhet e huaja janë një aset që do të merret në konsideratë

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për intervista.

*Kandidatët e interesuar janë të ftuar të aplikojnë duke dërguar CV-në e tyre me foto në adresën e e-mail-it **dahliacenter@hotmail.com** duke specifikuar pozicionin për të cilin po aplikojnë, **deri në datën 19 Shkurt 2016.***

Dahlia. Feel Better!

